

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	---

SCEL – 08 – 004

C-0035

*Ankuesja*

[REDACTED], Kruševac, Republika e Serbisë

Kundër

Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit  
Prishtnë

*E Paditura*

Për: Ankuesen  
Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM)  
Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP)

Dhoma e Posacme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Paneli Gjyqësor i përbërë nga Antoinette Lepeltier - Durel, Gjyqtar Kryesues, Esma Erterzi, dhe Gyltene Sylejmani, Gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21 janar 2011, lëshon këtë:

### AKT GJYKIM PLOTËSUES

1. Ankesa e Ankueses [REDACTED] e cila kërkon përfshirje në listë të punëtorëve me të drejta legjitime për pjesëmarrje në 20% e të hyrave nga privatizimi i NSH FAGAR, Podujevë, refuzohet si e pabazuar.
2. Ky aktgjykim plotëson aktgjykimin e datës 23 tetor 2008.
3. Në përputhje me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet me shkrim pranë kolegjit të ankesave të Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Ndërmarrja është privatizuar më 23 mars 2006.

Në pajtim me Nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikoi listën e punëtorëve me të drejta legjitime për pjesëmarrje në të hyrat nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore [REDACTED], Podujevë. Bazuar në lajmërimin e publikuar në gazetat përkatëse, afati i fundit për parashtrimin e ankesave në Dhomën e Posacme në lidhje me listën e publikuar ka qenë 2 qershor 2008.

Ankuesja parashtroi ankesën e saj më 30 maj 2008 pranë Shtyllës se IV-të UNMIK-ut (BE) në Beograd dhe është regjistruar pranë Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit më 21 korrik 2009.

Në pajtim me Nenin 67.7 të UA të UNMIK-ut 2008/6, një kopje e ankesës është dërguar nga Doma e Posacme tek Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si de facto trashëgimtare e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, dhe AKP-ja parashtroi vërejtjet e saj me shkrim brenda afatit kohor të përshkruar sipas Nenit 67.8 të UA të UNMIK-ut 2008/6 në gjuhën angleze dhe në gjuhën e ankeses.

Në përgjigjen e vetë të parashtruar më 28 korrik 2009, AKP-ja konstatoi se afati i fundit kohor për parashtrimin e ankesës në Dhomën e Posacme kishte skaduar më 2 qershor 2008, prandaj ka propozuar Dhomës së Posacme që të refuzojë ankesën si të papranueshme.

Në pajtim me nenin 67.9 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6, përgjigja e AKP-së i ishte dërguar Ankueses më 20 nëntor 2009. Në përgjigjen e saj të datës 9 dhjetor 2009 Ankuesja parashtroi vetëm ankesën e datës 30 maj 2008 e cila tashmë ishte parashtruar në Dhomën e Posacme.

Më 24 nëntor 2009 Doma e Posacme lëshoi një Aktvendim për vazhdimin e afatit kohor për 90 ditë, efektiv që nga data 20 tetor 2009.

Më 18 dhjetor 2009 Doma e Posacme urdhëroi AKP-në që të parashtrojë detajet nga Libri Amëz dhe dokumentet e tjera përkatëse dhe/apo të dhënët në lidhje me Ankuesen.

Më 28 dhjetor 2009 AKP-ja parashtroi një kopje të faqes 31 të Librit Amëz i NSH [REDACTED] Podujevë që ndërlidhet me Ankuesen.

## **Arsyetimi Ligjor**

Në me Nenin 67.7 të UA të UNMIK-ut 2008/6, Doma e Posacme vendos të mos zhvillojë procedurë gojore pasi që as Ankuesja dhe as i Padituri nuk kanë kërkuar me shkrim që të zhvillohet një seancë verbale.

Ankesa e Ankueses duhet të konsiderohet si e pranueshme për faktin se plotëson kushtin e paraparë në Nenin 67.6 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6. Dhoma e Posacme konsideron se ankesa është parashtruar brenda afatit kohor pasi që është parashtruar pranë Shtyllës se IV-të UNMIK-ut (BE) në Beograd më 30 maj 2008. Për arsyet e panjohura është dorëzuarën Dhomën e Posacme shumë pasi që ajo është parashtruar aty, me ç'rast është regjistruar më 21 korrik 2009.

Nenet 10.4 dhe 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 përcaktojnë kushtet për të qenë një punëtor me të drejtë legjitime përfshirje në listë. Neni 10.4 përcakton se punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar.

Dhoma e Posacme ka shqyrtuar ankesën e Ankueses dhe ka konstatuar se nuk është kontestuese që Ankuesja ka punuar në ndërmarrje prej vitit 1985 deri në vitin 1999. Në ankesën e saj Ankuesja ka kerkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për pjesëmarrje në aksionet nga privatizimi i NSH [REDACTED], Podujevë dhe ka dorëzuar së bashku me ankesën edhe kopjen e librezës së saj të punës si dhe vendimin e punësimit me Nr. 3057 të datës 30 prill 1992. Libreza e punës tregon që data e punësimit pranë NSH-së ka qenë 16 janar 1985. e njëjta mund të verifikohet nga libri amëz që është ofruar nga AKP-ja. Përfundimi i punësimit në këtë ndërmarrje konfirmohet nga vetë Ankuesja.

Nga këto fakte, Dhoma e Posacme konstaton se Ankuesja nuk ka punuar që nga viti 1999 deri në datën e privatizimit të ndërmarrjes, prandaj ajo nuk është regjistruar si një punëtore pranë NSH-së në kohën e privatizimit në mars të vitit 2006.

Ankuesja nuk ka deklaruar se ka qenë subjekt i diskriminimit.

Prandaj, për shkak të argumenteve dhe bazës ligjore të sipërvituar, Dhoma e Posacme vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë Ligjore:**

Në përputhje me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet me shkrim pranë kolegjit të ankesave të Dhomës së Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Antoinette Lepeltier – Durel, Gjyqtare Kryesuese EULEX

---

Esma Erterzi, EULEX Gjyqtare

---

Gyltene Sylejmani, Gjyqtare

---

Tobias Lapke, Regjistrues, EULEX

---